



Të nderuar kolegë,

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Shkencave Sportive (ASSA), Ju fton të merrni pjesë në Konferencën e 5-të Ndërkombëtare me temë **“Shkencat sportive, edukimi dhe roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqënien sociale”**, e cila do të mbahet në datat 12- 13 Prill, 2019, në Elbasan.

Në konferencë janë të ftuar kërkues, akademikë, profesionistë të sektorit të edukimit dhe shkencave të sportit, mësues, psikologë, punonjës socialë, studentë praktikantë, agjensi qeveritare dhe konsulentë, studiues të rinj dhe me përvojë, nga vendi ynë, trevat shqiptare, rajoni dhe vendet e BE-së, me qëllim që të prezantojnë kërkimet e tyre, të diskutojnë rreth gjetjeve kërkimore, të debatojnë për zgjidhje inovative, si dhe të shkëmbejnë përvoja dhe ide të ndryshme për kapërcimin e sfidave të shoqërisë së shekullit të 21-të.

Data të rëndësishme:

Afati për pranimin e abstrakteve	15 shkurt, 2019
Njoftimi për pranimin e abstraktit	01 mars, 2019
Afati për dorëzimin e punimit të plotë	15 mars, 2019
Data e konferencës	12-13 prill, 2019
Vendi i mbajtjes së konferencës	Universiteti “A.Xhuvani”, Elbasan

Temat kryesore:

Konferenca mirëpret një shumëllojshmëri të punimeve origjinale që hulumtojnë çështje të mprehta ndërdisiplinare që lidhen me fusha të ndryshme studimi, si: *edukimi, shkencat e sportit, shkencat humane, sociale, arti, qytetaria, filozofia, psikologjia, shëndeti mendor, mjedisi, drejtësia dhe barazia, multikuluralizmi, etj..*

Publikimi:

- Të gjitha punimet e pranuar do të botohen në Librin e Konferencës me ISBN.
- Punimet të cilat do të kalojnë me sukses rishikimin shkencor do të merren në konsideratë për botim në revistën shkencore të UE-së.

Gjuha e prezantimit: Shqip dhe Anglisht
Prezantimet mund të jenë: Personalisht ose Virtualisht
E-mail: konferencafshe2019@uniel.edu.al

Pjesëmarrja në konferencë për stafin akademik dhe studentët e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në Universitetin e Elbasanit, është pa tarifë.

Luteni të shpërndani njoftimin te kolegë të tjerë të interesuar.

Ne besojmë se kontributi Juaj do të shtojë vlerat shkencore të Konferencës Ndërkombëtare në “Shkencat sportive, edukimi dhe roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqënien sociale”, 2019!

Me respekt,

Doc. Dr. Edmond Biçoku

*Në emër të Bordit Organizator të Konferencës Ndërkombëtare, 2019
Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.*